



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 161

**Tiranë – E mërkurë, 30 gusht 2017**

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr.10596, datë 22.8.2017	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 7445
Dekret i Presidentit nr. 10597, datë 22.8.2017	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 7445
Dekret i Presidentit nr.10599, datë 29.8.2017	Për thirrjen e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë..... 7445
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë nr. 349, datë 23.8.2017	Për delegimin e kompetencave..... 7445
Vendim i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 18, datë 20.7.2017	Për anëtarësimin në skemën e sigurimit të depozitave dhe dhënien e certifikatës shoqërisë së kursim-kreditit “UniFin”..... 7446
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 123, datë 16.8.2017	Mbi kërkesën e kompanisë KESH sh.a. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a., lidhur me përbushjen e detyrimit të shërbimit publik që rrjedh nga vendimi i ERE-s nr. 194, datë 30.12.2016, “Për miratimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a., lidhur me mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, shërbimet ndihmëse dhe disbalancat”..... 7446
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 124, datë 16.8.2017	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike”..... 7447
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 125, datë 16.8.2017	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullave të harmonizuara të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit për vitin 2018 për Zyrën e Kordinimit të Ankandëve të Kapaciteteve të Interkonjeksionit në Europën Juglindore (SEE CAO)..... 7448
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 126, datë 16.8.2017	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror..... 7448

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 127, datë 16.8.2017	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror.....	7450
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 128, datë 16.8.2017	Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë “Ayen As Energji” sh.a. për modifikimin e licencës së “Prodhimit të energjisë elektrike” nr. 273, seria PV15K, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 32, datë 4.3.2015.....	7452
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 129, datë 16.8.2017	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Energy To Energy” sh.p.k. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.....	7453
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 130, datë 16.8.2017	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Eurobiznes” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC-et: “Lusen 1”, me fuqi të instaluar 0.315 MW; “Lusen 2”, me fuqi të instaluar 0.6 MW; “Lusen 3”, me fuqi të instaluar 0.6 MW; dhe me fuqi totale të instaluar 1.515 MW.....	7454
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 131, datë 16.8.2017	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “The Blue Star” sh.p.k. për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i “Goricë”, me fuqi të instaluar 1.747 MW.....	7455
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 132, datë 16.8.2017	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “The Blue Star” sh.p.k. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.....	7456
Kërkesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. 2728/10, datë 24.8.2017	Për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajjtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Sistemim-asfaltim i unazës së qytetit, faza I, bashkia Maliq” .....	7457
	Anekset e vendimit të Entit Rregullator të Energjisë, nr. 115, datë 27.7.2017, “Për miratimin e rregullave për garancitë financiare të pjesëmarrësve për regjistrim në tregun e energjisë elektrike”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 157, datë 9.8.2017.....	7463

**DEKRET**

Nr. 10596, datë 22.8.2017

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË  
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, dhe nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Arsimit dhe Sportit,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Ivan Salvador Balliu Campeny
2. Bardhec Ahmet Bytyqi
3. Zelfije Bashkim Bajramaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË

**Ilir Meta****DEKRET**

Nr. 10597, datë 22.8.2017

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË  
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, të neneve 9, 20 dhe 24 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Punëve të Brendshme,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Ilir Halit Kraja
2. Elvira Beqir Kraja (Perizoviq)
3. Endi Ilir Kraja

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË

**Ilir Meta****DEKRET**

Nr. 10599, datë 29.8.2017

**PËR THIRRJEN E KUVENDIT TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 67, pika 1 dhe 93 të Kushtetutës së Shqipërisë,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

Mbledhja e parë e legjislaturës së IX të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë thirret ditën e shtunë, datë 9 shtator 2017, ora 10.00.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË

**Ilir Meta****URDHËR**

Nr. 349, datë 23.8.2017

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 11 të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

**URDHËROJ:**

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Shëndetësisë, zëvendësministrit të Ministrisë së Shëndetësisë, znj. Mira Rakacolli, për drejtimin administrativ të institucionit, me përjashtim të kompetencave që ligji ia njeh shprehimisht ministrit të Shëndetësisë dhe që



kërkojnë nxjerrjen e urdhrave apo udhëzimeve përkatëse.

2. Zëvendësministri ndalohet të nëndelegojë te një organ i tretë kompetencat e përfituara përmes këtij akti delegimi.

3. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Shëndetësisë, sipas pikës 1 të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data 23.8.2017 dhe deri në shfuqizimin e këtij urdhri. Zëvendësministri për ushtrimin e kompetencave sipas këtij urdhri informon periodikisht ministrin e Shëndetësisë.

4. Ngarkohet Sektori i Shërbimeve Mbështetëse për njoftimin e këtij urdhri, nëpunësve të aparatit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të gjithë titullarëve të institucioneve të varësisë.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Shëndetësisë, znj. Mira Rakacolli dhe Sektori i Shërbimeve Mbështetëse.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I SHËNDETËSISË  
Arben Beqiri

**VENDIM**  
Nr. 18, datë 20.7.2017

**PËR ANËTARËSIMIN NË SKEMËN E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE DHE DHËNIEN E CERTIFIKATËS SHOQËRISË SË KURSIM-KREDITIT “UNIFIN”**

Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, në mbështetje të nenit 4, shkronja “a”, të nenit 23, të nenit 52, pika 1, shkronja “p”, të nenit 53, pika 5, shkronja “d” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 35, pika 4, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, si dhe të nenit 6, të nenit 7, të nenit 8 të udhëzimit nr. 4188, datë 1.9.2016, “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit”, si dhe shkresën e Bankës së Shqipërisë nr. 6605/9, Prot., datë 19.7.2017, për pajisjen e SHKK “UniFin” me licencën nr. 1/1, datë 14.7.2017, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm,

VENDOSI:

1. Për anëtarësimin në skemën e sigurimit të depozitave dhe dhënien e certifikatës shoqërisë së kursim-kreditit “UniFin”.

2. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm për dorëzimin e certifikatës shoqërisë së kursim-kreditit “UniFin”.

3. Të informohet Autoriteti Mbikëqyrës mbi këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet shoqërisë së kursim-kreditit “UniFin”, brenda 7 ditëve kalendarike nga miratimi i tij.

KRYETARI  
Donald Duraj

**VENDIM**  
Nr. 123, datë 16.8.2017

**MBI KËRKESËN E KOMPANISË “KESH” SHA PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJES NDËRMJET “KESH” SHA DHE “OST” SHA, LIDHUR ME PËRMBUSHJEN E DETYRIMIT TË SHËRBIMIT PUBLIK QË RRJEDH NGA VENDIMI I ERE-S NR. 194, DATË 30.12.2016, “PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË OST SHA, LIDHUR ME MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN E TRANSMETIMIT, SHËRBIMET NDIHMËSE DHE DISBALANCAT”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, germa “a” dhe “ë”, nenit 24, pikat 1, 2, 3, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 23, pika 12 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; gjithashtu dhe në zbatim të nenit 11 të “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror; nenit 18 të “Kontratës për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektroenergjitik”, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.8.2017, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike mbi kërkesën e kompanisë KESH sh.a. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a., lidhur me përmbushjen e detyrimit të



shërbimit publik që rrjedh nga vendimi i ERE-s nr. 194, datë 30.12.2016, “Për miratimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a., lidhur me mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, shërbimet ndihmëse dhe disbalancat”,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 619/1Prot, datë 4.8.2017, kompania KESH sh.a. ka paraqitur pranë ERE-s një kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes të lindur mes saj dhe kompanisë OST sh.a., si rezultat i përmbushje së detyrimit të shërbimit publik që rrjedh nga zbatimi i vendimit të ERE-s nr. 194, datë 30.12.2016, “Për miratimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a., lidhur me mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, shërbimet ndihmëse dhe disbalancat”.

- “Kontrata për sigurimin e shërbimeve ndihmëse të balancimit të sistemit energjetik”, e nënshkruar nga KESH sh.a. dhe OST sh.a., është miratuar me vendimin e ERE-s nr. 79, datë 7.6.2016, mbi miratimin e “Kontratës për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektroenergjetik për periudhën kohore 1.1.2016 – 30.6.2016” midis OST sh.a. dhe KESH sh.a, aktualisht është në fuqi referuar vendimit nr. 194, datë 30.12.2016 të ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Pranimin për shqyrtim nga ERE të ankesës së paraqitur nga kompania KESH sh.a., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a., lidhur me përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik që rrjedh nga vendimi i ERE-s nr. 194, datë 30.12.2016, duke filluar procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konform “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM

Nr. 124, datë 16.8.2017

#### MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “RREGULLAVE TË PËRKOHSHME PËR MEKANIZMIN BALANCUES TË ENERGIJË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të neneve 16, 98 dhe 100 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 19, pika 1, germa “P” dhe nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.8.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për draftregullat e përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- OST sh.a., me shkresën e tij nr. 4176 Prot., datë 1.8.2017, paraqiti në ERE për miratim draftin e rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike.

- Rregullorja është hartuar nga OST sh.a. në përputhje me nenet 98 dhe 100 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- OST sh.a., në shkresën e sipërcituar ka bërë me dije se drafti i këtyre rregullave është përgatitur me mbështetjen e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në kuadër të mbështetjes teknike të ofruar për këtë qëllim.

- Në kuadër të kësaj asistence, procesi i draftimit të këtyre rregullave ka përfshirë edhe organizimin e seminareve e takimeve të përbashkëta me palët e interesit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 125, datë 16.8.2017**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR  
MIRATIMIN E RREGULLAVE TË  
HARMONIZUARA TË ALOKIMIT TË  
KAPACITETEVE TË  
INTERKONJEKSIONIT PËR VITIN 2018  
PËR ZYRËN E KOORDINIMIT TË  
ANKANDEVE TË KAPACITETEVE TË  
INTERKONJEKSIONIT NË EUROPËN  
JUGLINDORE (SEE CAO)**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 30 dhe nenit 65 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 51 të rregullores së komisionit (BE) 2016/1719, “Për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve të ardhshme (*Forward Capacity Allocation – FLA*)”; nenit 19, pika 1, germa “P” dhe nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.8.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për “Fillimin e procedurave për miratimin e rregullave të harmonizuara të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit për vitin 2018 për Zyrën e Koordinimit të Ankandeve të Kapaciteteve të Interkonjeksionit në Evropën Juglindore (SEE CAO)”, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 4111 Prot, datë 26.7.2017, OST sh.a. ka paraqitur pranë ERE-s kërkesën për miratimin e “Rregullave të harmonizuara të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit për vitin 2018 për Zyrën e Koordinimit të Ankandeve të Kapaciteteve të Interkonjeksionit në Evropën Juglindore (SEE CAO).

- Operatorët e Sistemit të Transmetimit të SEE dhe Zyra e Koordinuar e Ankandit në Evropën Juglindore (SEE CAO) kanë përgatitur një grup të ri rregullash për të zbatuar Rregullat e Harmonizuara të Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksionit (referuar si HAR), në rajonin e Evropës Juglindore për procesin e ankandit për vitin 2018.

- Rregullorja është hartuar në përputhje me nenin 51 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719, datë 26 shtator, për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve të ardhshme

(*FORWARD CAPACITY ALLOCATION – FLA*).

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Rregullave të harmonizuara të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit për vitin 2018 për Zyrën e Koordinimit të Ankandeve të Kapaciteteve të Interkonjeksionit në Evropën Juglindore (SEE CAO).

2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM****Nr. 126, datë 16.8.2017**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR  
LICENCIMIN E SHOQËRISË ALBGAZ  
SHA NË AKTIVITETIN E  
SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të neneve 4, pika 50 dhe nenit 22, pika 2, germa “b” dhe nenit 50 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin gazit natyror”, si dhe neneve 4, pika 1, germa “a”; nenit 5; nenit 8; nenit 9 pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 2, germa “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”; nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.8.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:



Aplikimi i shoqërisë “Albgaz” sh.a. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, si më poshtë:

Formati dhe dokumentacioni për aplikim është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:

Neni 9, pika 1:

- germa “a” (tipi i aplikimit) plotësuar;
- germa “b” (informacion i përgjithshëm për aplikantin) plotësuar;

- germa “c” (të dhënat mbi aplikantin) plotësuar;
- germa “d” (dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor), plotësuar si më poshtë:

- pika “i” (akti i regjistrimit në QKB) plotësuar;
- pika “ii” (struktura organizative/lista e personelit) plotësuar;

- pika “iv” (identiteti i të gjithë personave që kanë interes pronësor tek aplikanti më të madh dhe të barabartë me 5%) pa plotësuar;

- pika “v” (dokumentacioni që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka... për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar). Subjekti ka depozituar në ERE listën e asetëve në zbatim të urdhrit të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 550/1, datë 2.2.2016, që do të shërbejë për krijimin e Qendrës së Transmetimit dhe Shpërndarjes së Gazit, si dhe disa certifikata pronësie për prona që i përkasin ende Albpetrolit dhe që pritet të regjistrohen në emër të “Albgaz” sh.a.

- Pika “vi” (lejet dhe autorizimet mjedisore) pa plotësuar.

- Germa “e” (dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale), plotësuar si më poshtë:

- “i” (deklarime prej autoriteteve për pagesat e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore...) Subjekti ka depozituar në ERE vetëm vërtetimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, i cili konfirmon se subjekti nuk ka detyrime tatimore deri në datë 19.7.2017. Mungon deklarata e sigurimeve shoqërore.

- “ii” (bilancet financiare të audituara...për tre vitet e fundit). Duke qenë se viti financiar 2017 nuk është mbyllur ende, shoqëria Albgaz sh.a. nuk mund të depozitojë në këtë moment bilance financiare pranë ERE-s, duke qenë një shoqëri e krijuar para pak muajsh.

- “v” (vërtetimi i kryerjes së pagesës ndaj ERE-s, tarifë aplikimi), kryer pagesa pranë ERE-s.

- “vi” (plan biznesi...) Subjekti ka depozituar në ERE një program zhvillimi ekonomik për vitin 2017, në pritje të depozitimit të një plani biznesi.

- “vii” (nëse aplikanti ka synim të përdorë një shoqëri menaxhimi për operacionet e tij ditore, duhet të këshillohet me ERE-n dhe të japë garanci performace për kryerjen me besueshmëri të veprimeve të kësaj shoqërie menaxhimi). Nuk është dhënë asnjë informacion për këtë nga shoqëria.

Dokumente specifike për llojin e licencës, është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:

Neni 9, pika 2, germa “b”:

Licenca për shpërndarjen e gazit natyror:

Informacion me të dhëna të përgjithshme dhe teknike të projektit që përfshijnë sa vijon:

i) Vendndodhjen e instalimeve dhe gjurmën e tubacioneve përfshirë hartën topografike. Pa plotësuar.

ii) Zonën gjeografike të mbuluar nga aplikimi. Pa plotësuar.

iii) Kapacitetin maksimal teknik të kontraktuar dhe të disponueshëm në të gjitha pikat e hyrjes (*in take*) në sistem dhe të daljes (*off take*) prej sistemit dhe ndërlidhjet e tij me rrjetet e tjera të transmetimit dhe shpërndarjes, impiantet e magazinimit, prodhimit dhe terminallet e GNL-së. Pa plotësuar.

iv) Volumet e projektuara ditore për t'u përpunuar sipas vlerësimeve të aplikantit. Pa plotësuar.

v) Standardet teknike, presionet maksimale të projektuara, kërkesat e komprimimit dhe karakteristikat e tjera teknike të makinerive dhe pajisjeve teknike që do të instalohen. Pa plotësuar.

vi) Presionet e punës të projektuara mbështetur në vlerësimet e aplikantit. Pa plotësuar.

vii) Kategoritë e konsumatorëve dhe livrimet e projektuara. Pa plotësuar.

viii) Vendndodhjet e matësve dhe specifikimet. Pa plotësuar.

ix) Planet e aromatizimit përfshirë vendndodhjet. Pa plotësuar.

x) Dëshmi të kontratave/angazhimeve. Pa plotësuar.



xi) Kërkesat e pritshme për hyrje prej palëve të treta ose çdo kërkesë e pritshme për përjashtim nga e drejta për hyrjen e palëve të treta sikurse çdo vendim i dhënë më parë për përjashtim prej detyrimit të dhënies së të drejtës së hyrjes për infrastrukturën e reja sipas ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”. Pa plotësuar.

xii) Lidhjet ndërrajonale dhe parametrat e operimit të OSSH-së fqinje nëse është e përshtatshme. Pa plotësuar.

xiii) Aftësia për lëvizjen në kah të kundërt nëse është e përshtatshme. Pa plotësuar.

xiv) Punët e aplikantit për: a) zgjidhjen teknike të propozuar; b) vlerësimin e ndikimit mjedisor; c) vlerësimin e kostos; d) parashikimet ekonomike, duke përfshirë mënyrat e financimit të cilat justifikojnë planin e biznesit për projektin e shpërndarjes të gazit natyror të përgatitura nga një firmë e specializuar inxhinierike. Pa plotësuar.

xv) Programin e punës për zbatimin e projektit dhe jeta e pritshme e projektit. Pa plotësuar.

xvi) Planet vjetore të investimit për përmirësimin, zgjerimin ose modifikime të tjera të sistemit të shpërndarjes për një periudhë jo më pak se 5 vjet prej datës efektive të licencës në përputhje me legjislacionin në fuqi. Pa plotësuar.

xvii) Programi i parashikuar i mirëmbajtjes së sistemit të shpërndarjes. Pa plotësuar.

xviii) Sasia mesatare e gazit natyror që parashikohet për t’u shpërndarë gjatë një viti mbështetur në një program tipik mujor. Pa plotësuar.

Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, neni 10, pika 9 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë subjektin e interesuar për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM

Nr. 127, datë 16.8.2017

#### MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË ALBGAZ SHA NË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të neneve 4, pika 50, dhe nenit 44, pika 2, germa “a”, dhe nenit 35 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe neneve 4, pika 1, germa “a”; neni 5; neni 8; neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 2, germa “a” dhe neni 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”; neni 19, pika 1, germa “a” të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.8.2017, mbasi shqyrtoi relacionin, fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Albgaz” sh.a. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, si më poshtë:

Formati dhe dokumentacioni për aplikim është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:

Neni 9, pika 1:

- germa “a” (tipi i aplikimit) plotësuar;
- germa “b” (informacioni i përgjithshëm për aplikantin) plotësuar;
- germa “c” (të dhënat mbi aplikantin) plotësuar;
- germa “d” (dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor), plotësuar si më poshtë:





- pika “i” (akti i regjistrimit në QKB) plotësuar;
- pika “ii” (struktura organizative/lista e personelit) plotësuar;
- pika “iv” (identiteti i të gjithë personave që kanë interes pronësor tek aplikanti më të madh dhe të barabartë me 5 %) pa plotësuar;
- pika “v” (dokumentacioni që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka...për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar). Subjekti ka depozituar në ERE listën e asetëve në zbatim të urdhrimit të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 550/1, datë 2.2.2016, që do të shërbejë për krijimin e Qendrës së Transmetimit dhe Shpërndarjes së Gazit, si dhe disa certifikata pronësie për prona që i përkasin ende Albpetrolit dhe që pritet të regjistrohen në emër të “Albgaz” sh.a.
- Pika “vi” (lejet dhe autorizimet mjedisore) pa plotësuar.
- Germa “e” (dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale) plotësuar si më poshtë:
- “i” (deklarime prej autoriteteve për pagesat e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore...) Subjekti ka depozituar në ERE vetëm vërtetimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, i cili konfirmon se subjekti nuk ka detyrime tatimore deri në datë 19.7.2017. Mungon deklarata e sigurimeve shoqërore.
- “ii” (bilancet financiare të audituara...për tri vitet e fundit). Duke qenë se viti financiar 2017 nuk është mbyllur ende, shoqëria “Albgaz” sh.a. nuk mund të depozitojë në këtë moment bilance financiare pranë ERE-s, duke qenë një shoqëri e krijuar para pak muajsh.
- “v” (vërtetimi i kryerjes së pagesës ndaj ERE-s, tarifë aplikimi). Duke qenë se mbas vendimmarrjes së ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017, “Për miratimin e rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, është konstatuar një gabim material në aktin që i është bashkëlidhur këtij vendimi e dërguar në QBZ, ERE, në bazë të nenit 112 të Kodit të Procedurave Administrative (korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ), ka depozituar në QBZ kërkesën për të bërë zëvendësimin e tabelës së aneksit A, “Pagesa e regjistrimit dhe procedimit të një aplikimi”, duke shtuar në përmbajtjen e saj edhe pagesën e aplikimit për licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror. Me botimin në

Fletoren Zyrtare të këtij korrigjimi do t’i kërkohej subjektit “Albgaz” sh.a të kryejë pagesën përkatëse.

- “vi” (plan biznesi...). Subjekti ka depozituar në ERE një program zhvillimi ekonomik për vitin 2017, në pritje të depozitimit të një plani biznesi.

- “vii” (nëse aplikanti ka synim të përdorë një shoqëri menaxhimi për operacionet e tij ditore, duhet të këshillohet me ERE-n dhe të japë garanci performance për kryerjen me besueshmëri të veprimeve të kësaj shoqërie menaxhimi). Nuk është dhënë asnjë informacion për këtë nga shoqëria.

Dokumente specifike për llojin e licencës, është plotësuar nga aplikanti, si më poshtë:

Neni 9, pika 2, germa “a”:

Licenca për transmetimin e gazit natyror:

a.1 Subjekti që aplikon për një licencë në transmetimin e gazit natyror, duhet që më parë të certifikohet sipas procedurës së përcaktuar në nenin 37 të ligjit 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”. Për këtë pikë vlen të theksojmë faktin se jemi ende në fazë pritje të opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në lidhje me certifikimin paraprak të “Albgaz” nga ERE.

a.2 Informacion me të dhëna të përgjithshme dhe teknike të projektit që përfshijnë sa vijon:

i) Vendndodhjen e instalimeve dhe gjurmën e tubacioneve përfshirë hartën topografike për territorin ku do të ushtrrojë aktivitetin. Pa plotësuar.

ii) Kapacitetin maksimal teknik të kontraktuar dhe të disponueshëm në të gjitha pikat e hyrjes (*in take*) në sistem dhe të daljes (*off take*) prej sistemit dhe ndërlidhjet e tij me rrjete të tjera të transmetimit dhe shpërndarjes, impiantet e magazinimit, prodhimit dhe termialet e GNL-së. Pa plotësuar.

iii) Volumet e projektuara ditore për t’u përpunuar sipas vlerësimeve të aplikantit. Pa plotësuar.

iv) Standardet teknike, presionet maksimale të projektuara, kërkesat e komprimimit dhe karakteristikat e tjera teknike të makinerive dhe pajisjeve teknike që do të instalohen. Pa plotësuar.

v) Presionet e punës të projektuara mbështetur në vlerësimet e aplikantit. Pa plotësuar.

vi) Kategoritë dhe lista e konsumatorëve, si dhe livrimet e parashikuara. Pa plotësuar.

vii) Vendndodhjet e matësve dhe specififikimet. Pa plotësuar.

viii) Vendndodhjet e kontrollit të cilësisë së gazit. Pa plotësuar.



ix) Dëshmi të kontratave/angazhimeve për transportin e gazit. Pa plotësuar.

x) Kërkesat e pritshme për hyrje prej palëve të treta ose çdo kërkesë e pritshme për përjashtim nga e drejta për hyrje e palëve të treta, sikurse çdo vendim i dhënë më parë për përjashtim prej detyrimit të dhënies së të drejtës së hyrjes për infrastrukturën e reja sipas ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”. Pa plotësuar.

xi) Lidhjet ndërkufitare dhe parametrat e operimit në vendet fqinje. Pa plotësuar.

xii) Marrëveshjet operationale të balancimit. Pa plotësuar.

xiii) Burimi i synuar dhe procedura e prokurimit të gazit natyror të nevojshëm për balancimin e sistemit të transmetimit. Pa plotësuar.

xiv) Aftësia për lëvizjen në kah të kundërt. Pa plotësuar.

xv) Punët e aplikantit për: a) zgjidhjen teknike të propozuar; b) vlerësimin e ndikimit mjedisor; c) vlerësimin e kostos; d) parashikimet ekonomike duke përfshirë mënyrat e financimit të cilat justifikojnë planin e biznesit për projektin e transmetimit të gazit natyror të përgatitura nga një shoqëri e specializuar inxhinierike. Pa plotësuar.

xvi) Programin e punës për zbatimin e projektit dhe jeta e pritshme e projektit. Pa plotësuar.

xvii) Planet vjetore të investimit për përmirësimin, zgjerimin ose modifikime të tjera të sistemit të transmetimit për një periudhë jo më pak se 5 vjet prej datës efektive të licencës në përputhje me legjislacionin në fuqi. Pa plotësuar.

xviii) Programi i parashikuar i mirëmbajtjes së sistemit të transmetimit. Pa plotësuar.

Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet subjekti që, në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, neni 10, pika 9 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror.

2. Procedura e nisur sipas pikës 1 të këtij vendimi do të mbyllet mbas marrjes së vendimit final të certifikimit të shoqërisë “Albgaz” sh.a. si operator i kombinuar.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë subjektin e interesuar për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM

Nr. 128, datë 16.8.2017

**MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË  
SHOQËRISË “AYEN AS ENERGJI” SHA  
PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË  
“PRODHIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE” NR. 273, SERIA PV15K, TË  
MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT  
TË ERE-S NR. 32, DATË 4.3.2015**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 365, datë 4.5.2011, “Marrëveshje kocensionare me nr. 5446 Rep; nr. 1944 Kol., datë 2.5.2011”, të ndryshuar; nenit 15 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; neni 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.8.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për modifikimin e licencës së shoqërisë “Ayen As Energji” sh.a., përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

- Shoqëria “Ayen As Energji” sh.a. është licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Gojan”, “Gjegjan”, “Peshqesh” dhe “Fangu”, me fuqi totale të instaluar 110.54 MW, me vendimin e bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 32, datë 4.3.2015.

- Shoqëria “Ayen As Energji” sh.a. ka nënshkruar një kontratë shtesë të koncesionit me nr. 217 Rep., nr. 68/1 Kol., datë 20 janar 2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën e



koncesionit të formës BOT”, kontratës koncesionare nr. 5446 Rep., nr. 1944 Kol., datë 2.5.2011; ndryshuar për sa vijon “Të zbatohet projektin për ndërtimin e hidrocentraleve të Peshqeshit, Ura e Fanit, Fangut, me një fuqi totale 109.71 MW.”

- Dokumentacioni i depozituar në ERE nga shoqëria “Ayen As Energji” sh.a., në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, rezulton si më poshtë:

- Neni 9, pika 1: germa “a” (të dhënat për aplikim), germa “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit) dhe germa “c” (të dhëna për aplikuesin). Plotësuar.

- Neni 15, pika 4, germa “a”, një informacion me shkrim, ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës. Plotësuar.

- Germa “b”, vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës. Plotësuar.

- Germa “c”, miratimin e modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera. Plotësuar.

- Germa “d”, ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit sipas legjislacionit në fuqi. Plotësuar.

- Germa “e”. Të ketë kryer pagesat e rregullimit në ERE, plotësuar.

- Në vendimin nr. 105, datë 10.7.2017, bordi i ERE-s vendosi: fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë “Ayen As Energy” sh.a., dhënë me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 32, datë 4.3.2015, me nr. 273, seria PV15K, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et e “Gojanit”, “Gjegjanit”, “Peshqesh”, “Ura e Fanit” dhe “Fangu”, me fuqi totale 110.54 MW, në përputhje me parashikimet e kontratës shtesë të koncesionit me nr. 217 Rep., nr. 68/1 Kol., datë 20 janar 2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën e koncesionit të formës BOT”, kontratës koncesionare nr. 5446 Rep., nr. 1944 Kol., datë 2.5.2011.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të modifikojë licencën e shoqërisë “Ayen As Energji” sh.a., me numër me nr. 273, seria PV15K, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et

“Gojan”, me fuqi 12.25 MW, “Gjegjan”, me fuqi 6.55 MW, “Peshqesh”, me fuqi 27.94 MW dhe “Fangu”, me fuqi 63.8 MW, me fuqi totale 110.54 MW, për një afat 30-vjeçar, lëshuar me vendim të bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 32, datë 4.3.2015.

2. Emërimi i HEC-ve do të jetë: “Peshqesh”, me fuqi 34 MW; “Ura e Fanit”, me fuqi 1.11 MW, dhe “Fangu”, me fuqi 74.6 MW, me një fuqi totale të instaluar 109.71 MW.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM

Nr. 129, datë 16.8.2017

#### **MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGY TO ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e”; 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19, pika 1, germa “a” e “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.8.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Energy To Energy” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:



- Shoqëria “Energy To Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 530 Prot., datë 25.7.2017, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim ky subjekt me shkresën e datës 2.8.2017, protokolluar në ERE me nr. 530/1, datë 2.8.2017, ka përcjellë plotësimin e dokumentacionit në lidhje me aplikimin për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “Energy To Energy” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni tekniko - ekonomik (neni 9, pika 4.8, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Energy To Energy” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**

#### VENDIM Nr. 130, datë 16.8.2017

#### **MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “EUROBIZNES” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA HEC-ET: “LUSEN 1”, ME FUQI TË INSTALUAR 0.315 MW; “LUSEN 2”, ME FUQI TË INSTALUAR 0.6 MW; “LUSEN 3”, ME FUQI TË INSTALUAR 0.6 MW; DHE ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 1.515 MW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 7.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; nenit 5, pika 1, germa “a”; nenit 10, pika 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; neni 19, pika 1, germa “a” të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.8.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Eurobiznes” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Eurobiznes” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar tërësisht.



- Dokumentacioni teknik për HEC (neni 9, pika 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3 germat “a”, “b”; 4.1.4) është plotësuar tërësisht.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

Nenin 9, pika 4.1.3, germa “c”, shtrirja gjeografike e vendit ku do të ngrihet apo zhvillohet veprimtaria duke dhënë referencat ekzakte (numër parcele, numër regjistri kadastrë) dhe të paraqitura në hartë me shkallë 1: 25000 dhe germa “d”, një hartë topografike ku të paraqitet gjurma e linjës transmetuese në shkallë 1: 25000.

- Nenin 9, pika 4.1.5, germa “a”, miratimi i pikës së lidhjes, dhe germa “b”, leja e përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike, do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Eurobiznes” sh.p.k. për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Lusen 1”, me fuqi të instaluar 0.315 MW; “Lusen 2”, me fuqi të instaluar 0.6 MW; “Lusen 3”, me fuqi të instaluar 0.6 MW; dhe me fuqi totale të instaluar 1.515 MW, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektin e interesuar për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**

#### VENDIM Nr. 131, datë 16.8.2017

#### **MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË “THE BLUE STAR” SHPK, PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-I “GORICË”, ME FUQI TË INSTALUAR 1.747 MW**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1 germa “a”; 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe neneve 15 dhe 19 të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.8.2017, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “The Blue Star” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “The Blue Star” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “b”, “c”, “e”, “f”) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3, germat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni teknik për HEC (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3; 4.1.4; 4.1.5) është plotësuar tërësisht.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 2, germa “a” (akti i themelimit të shoqërisë);

- Neni 9, pika 2, germa “d” (vërtetimi nga gjykata);

- Neni 9, pika 2, germa “g” (dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shitblerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti), do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “The Blue Star” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i “Goricë”, me fuqi të instaluar 1.747 MW, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM

Nr. 132, datë 16.8.2017

### MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “THE BLUE STAR” NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1 germa “e”; 13 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe neneve 15 dhe 19 të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar

me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.8.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “The Blue Star” sh.p.k., të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “The Blue Star” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat , “b”, “c”, “e”) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” “d”) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni tekniko - ekonomik (neni 9, pika 4.8, germa “c”) është plotësuar tërësisht.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 2, germa “a” (akti i themelimit të shoqërisë);

- Neni 9, pika 2, germa “d” (vërtetimi nga gjykata);

- Neni 9, pika 4.8, germa “a”/”d”, sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar sipas viteve; germa “b”, kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti; do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “The Blue Star” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

### KËRKESË

Nr. 2728/10, datë 24.8.2017

### PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve të Brendshme shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Sistemim-asfaltim i unazës së qytetit, faza I, bashkia Maliq”.

Subjekti kërkues është bashkia e Maliqit.

Me anë të këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në

bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim.

Vlera totale e shpronësimit është 621,250 (gjashtëqind e njëzet e një mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I PUNËVE TË  
BRENDSHME  
Rovena Voda

**Lista emërore e personave dhe pronave që do të shpronësohen për realizimin e projektit “Sistemim-asfaltim i unazës së qytetit, faza e I-rë”**

#### Bashkia Maliq

Nr.	Emri Mbiemri	Zona Kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e truallit/m <sup>2</sup>	Çmimi i truallit/lek	Vlera e përgjithshme /lek	Lloji i dokumentit
1	Sanaber Agolli Liri Agolli Muhamare Agolli Repubilkë Agolli Leonart Agolli Arjan Agolli Alma Agolli	2573	1/206	200	1775	355 000	Vërtetim pronësie
2	Tahir Agolli Razije Agolli Vergjinush Agolli Zhaneta Agolli Shqiperie Agolli	2573	1/328	123	1775	218 325	Vërtetim pronësie
3	Pavlo Mentor Agolli Vergjina Agolli Dhimitri	2573	1/329	27	1775	47 925	Vërtetim pronësie
	<b>Totali</b>			<b>350</b>		<b>621 250</b>	



Anekset e vendimit të Entit Rregullator të Energjisë, nr. 115, datë 27.7.2017, “Për miratimin e rregullave për garancitë financiare të pjesëmarrësve për regjistrim në tregun e energjisë elektrike”, botuar në Fletoren Zyrtare 157, datë 9.8.2017

### Ankesë

#### Formular i regjistrimit nga subjektet e licencuara në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike

1. Licencëne lëshuar nga ERE ose licenca të tjera (që lidhen me tregun e energjisë) që zotëron kompania edhe në vende të tjera, nëse ka.	
2. Të dhëna mbi subjektin e licencuar (shtetëror, privat, aksioner i vetëm, shoqeri aksionere etj.).	
3. Volumi në MWh (kontrata të lidhura/të tregtuara) në treg të energjisë elektrike, dy vitet e fundit, brenda apo jashtë vendit, nëse ka.	
4. Të dhëna për bankën (nr. e llog., garancinë bankare etj., që kanë të bëjnë me tregun e energjisë).	
5. Të dhëna mbi IT (që zotëron për komunikim në treg).	
6. Ekstraktin nga QKR-ja (Qendra Kombëtare e Regjistrimit).	





## Formular i regjistrimit nga prodhuesit elektrikë

1. Licencën e lëshuar nga ERE ose licenca të tjera (që lidhen me tregun e energjisë) që zotëron kompania, nëse ka.	
2. Të dhëna mbi subjektin e licencuar (shtetëror, privat, aksioner i vetëm, shoqëri aksionere etj.).	
3. Volumi në MWh (kontrata të lidhura/të tregtuara) në treg të energjisë elektrike, dy vitet e fundit, nëse ka).	
4. Të dhëna për bankën (nr. e llog., garancinë bankare etj., që kanë të bëjnë me tregun e energjisë).	
5. Të dhëna për njësinë gjeneruese (tipi i centralit, lënda e parë për prodhimin e energjisë, numri i njësive gjeneruese, fuqia e instaluar për çdo njësi gjeneruese (nominale, minimale, maksimale), viti instalimit, prodhimi mesatar shumëvjeçar, kosto e lëshimit të njësisë gjeneruese, koha e lëshimit dhe e rilëshimit të njësisë gjeneruese, kosto për njësi prodhimi KWh (fikse, variabël).	
6. Të dhëna mbi pikën e lidhjes në rrjet (rajoni gjeografik, niveli i tensionit, pikën e matjes së energjisë së prodhuar).	
7. Të dhëna mbi IT (që zotëron për komunikim në treg).	
8. Ekstraktin nga QKR-ja (Qendra Kombëtare e Regjistrimit).	



## Formular i regjistrimit nga furnizuesit

1. Licencën e lëshuar nga ERE ose licenca të tjera (që lidhen me tregun e energjisë) që zotëron kompania, nëse ka.	
2. Të dhëna mbi subjektin e licencuar (shtetëror, privat, aksioner i vetëm, shoqëri aksionere etj.).	
3. Volumi në MWh (kontrata të lidhura/të siguruara) në treg të energjisë elektrike, dy vitet e fundit, brenda apo jashtë vendit, nëse ka.	
4. Të dhëna për bankën (nr. e llog., garancinë bankare etj., që kanë të bëjnë me tregun e energjisë).	
5. Të dhëna për konsumatorin/konsumatorët (tipi i konsumatorit, konsumi vjetor mesatar shumëvjeçar, koston e energjisë së mosfurnizuar – nëse ka, “rate” për njësi produkti, nëse ka).	
6. Të dhëna mbi pikën e lidhjes në rrjet (rajoni gjeografik, niveli i tensionit, pikën e matjes së energjisë së prodhuar).	
7. Të dhëna mbi IT (që zotëron për komunikim në treg).	
8. Ekstraktin nga QKR-ja (Qendra Kombëtare e Regjistrimit).	



## Formular i regjistrimit nga KESH sh.a. në cilësinë e gjeneruesit publik

1. Licencën e lëshuar nga ERE ose licenca të tjera (që lidhen me tregun e energjisë) që zotëron kompania, nëse ka.	
2. Të dhëna mbi subjektin e licencuar (shtetëror, privat, aksioner i vetëm, shoqëri aksionere etj.).	
3. Volumi në MWh (kontrata të lidhura /prodhuara) në treg të energjisë elektrike, dy vitet e fundit, brenda apo jashtë vendit, nëse ka.	
4. Të dhëna për bankën (nr. e llog., garancinë bankare etj., që kanë të bëjnë me tregun e energjisë).	
5. Të dhëna për njësinë gjeneruese (tipi i centralit, lënda e parë për prodhimin e energjisë, numri i njësive gjeneruese, viti i instalimit, prodhimi mesatar shumëvjeçar, kosto për njësi prodhimi energjie/kapaciteti lekë/MWh, MW-fikse, variabël, humbjet (G, TrF) e energjisë MWh/vit).	
6. Të dhëna mbi pikat e lidhjes në rrjet (rajoni gjeografik, niveli i tensionit, pikat e matjes së energjisë së prodhuar).	
7. Të dhëna mbi IT (që zotëron për komunikim në treg).	
8. Ekstraktin nga QKR-ja (Qendra Kombëtare e Regjistrimit).	



## Formular i regjistrimit nga Furnizuesi i Shërbimit Universal

1. Licencën e lëshuar nga ERE ose licenca të tjera (që lidhen me tregun e energjisë) që zotëron kompania, nëse ka.	
2. Të dhëna mbi subjektin e licencuar (shtetëror, privat, aksioner i vetëm, shoqëri aksionere etj.).	
3. Volumi në MWh (sipas kontratave të lidhura dhe/ose furnizuara konsumatorëve në treg të energjisë elektrike, dy vitet e fundit), nëse ka.	
4. Të dhëna mbi konsumin dhe konsumatorët (grafik tip ngarkese ditore, sipas sezoneve të vitit, sipas rajoneve, për grupimet e konsumatorëve; koston e energjisë së mosfurnizuar, për grupimet e konsumatorëve), nëse ka.	
5. Të dhëna për bankën (nr. e llog., garancinë bankare etj., që kanë të bëjnë me tregun e energjisë).	
6. Të dhëna mbi IT (që zotëron për komunikim në treg).	
7. Ekstraktin nga QKR-ja (Qendra Kombëtare e Regjistrimit).	



## Formular i regjistrimit nga OSSH-ja (Operatori i Sistemit të Shpërndarjes)

1. Licencën e lëshuar nga ERE ose licenca të tjera (që lidhen me tregun e energjisë elektrike), që zotëron kompania, nëse ka.	
2. Të dhëna mbi subjektin e licencuar (shtetëror, privat, aksioneri i vetëm, shoqëri aksionere etj.).	
3. Volumi në MWh (kontrata të lidhura /shpërndara) në treg të energjisë elektrike dy vitet e fundit, brenda apo jashtë vendit, nëse ka.	
3 Të dhëna mbi gjenerimin në rrjetin e tij (prodhimi mesatar vjetor; prodhimi mesatar sipas sezoneve, rajoneve, nivelit të tensionit, kosto mesatare e prodhimit - fikse, variabël).	
5. Të dhëna për bankën (nr. e llog., garancinë bankare, etj., që kanë të bëjnë me tregun e energjisë).	
6. Të dhëna për rrejtin e shpërndarjes (gjatësia e rrjetit sipas llojit dhe nivelit të tensionit, rajonizimi i rrjetit, energjia mesatare shumëvjeçare e shpërndarjes, kosto për njësi shpërndarje energjie/kapaciteti lekë/MWh, MW, humbjet e energjisë në rrjet sipas nivelit të tensioneve dhe rajoneve MWh/vit).	
7. Të dhëna mbi pikën e lidhjes në rrjetin e transmetimit (rajoni gjeografik, niveli i tensionit, pikën e matjes së energjisë).	
8. Të dhëna mbi IT (që zotëron për komunikim në treg).	
9. Ekstraktin nga QKR-ja (Qendra Kombëtare e Regjistrimit).	

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2017

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 168 lekë